



Prishtinë: 29.03.2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_957\_2018

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1547\_12\_16**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **13.06.2017**.

### në seancën e mbajtur më datë 29.03.2018, nxori këtë:

#### V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin N.B pronar i pompës së derivateve "Petrol Oti Slovenia" nga Prishtina, me shifër të konsumatorit **DPR - 90075284** si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1547\_12\_16 i datës 30.01.2017.

#### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 13.06.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se vendimi i DMK-së është bazuar në Pëlqimi Elektroenergjetik për furnizim me energji elektrike perkatesisht paragrafin 7 ku thuhet se **"KEK ka në dispozicion të vetin menaxhimin e tërë rrjetin e 10 kV, përfshi edhe pjesën e LP ajror dhe kablovik të cilin e ka ndërtuar investitori për kycjen e trafostacionit të vet. Po ashtu KEK do të menaxhoj me një kthinë hyrëse 20 (10) kV në trafostacionin e ri"**. Bazuar në këtë sipas KESCO-s, KEK asnjëherë nuk ka bërë transferimin e këtij aseti si të vetin por që bazuar në paragrafin e potencuar ka në dispozicion menaxhimin e saj për nevoja të operimit (shkyçje dhe rikyçje). Po ashtu KESCO ka potencuar se në listën e aseteve të bartura nga KEK në KEDS, nuk figuron se ky aset ka kaluar në pronësi të KWEK-ut pasi që për kalimin e aseteve në pronësi të operatoreve duhet një marrëveshje e veçantë në mes të dy palëve.

Bazuar në këtë KESCO kërkon nga Bordi që të pezulloi vendimin e DMK/ZRRE \_V\_1547\_12\_16, në lidhje me shifrën **DPR - 90075284** si të pabazuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të KESCO-së, se KEK asnjëherë nuk ka bërë transferimin e këtij asemi si te vetin por që bazuar në paragrafin e potencuar ka në dispozicion menaxhimin e saj për nevojat e operimit shkyçje dhe rikyçje dhe se në listën e aseteve të bartura nga KEK në KEDS, nuk figuron se ky aset ka kaluar në pronësi të KEK-ut pasi që për kalimin e aseteve në pronësi të operatorëve duhet një marrëveshje e veçantë në mes të dy palëve nuk qëndron pasi që nën 7 i PPE i KEK i datës 04.10.2011 thekson se ***“KEK ka në dispozicion të vetin menaxhimin e tërë rrjetin e 10 kV, përfshi edhe pjesën e LP ajror dhe kabllovik të cilin e ka ndërtuar investitori për kyçjen e trafostacionit të vet. Po ashtu KEK do të menaxhojë me një kthinë hyrëse 20 (10) kV në trafostacionin e ri”***.

Bordi i ZRRE ka analizuar ankesën e kompanisë “Petrol Oti Slovenia” të cilën e ka parashtruar në KEDS me të cilën ka kërkuar nga KEDS që të dalë një ekip për evitimin e një problemi të shfaqur në kablirin e cili bënë furnizimin e energjisë elektrike të kësaj kompanie e të cilën kërkesë e ka përsëritur edhe me datë 01.08.2016. Me datë 09.08.2016 përmes një shkresë zyrtare KEDS i është përgjigjur konsumatorit duke theksuar se kemi analizuar kërkesën e juaj në lidhje me defektin e linjës 10 kV prej nga furnizohet pompa e benzinës në fshatin Stanovc. Më tej është theksuar se kjo pjesë e linjës është aset i “Petrol Oti Slovenija” që nuk është transferuar si aset i KEDS dhe meqenëse në nuk kemi marrëveshje me kompaninë tuaj për mirëmbajtjen e këtij asemi, atëherë ju duhet të riparoni defektin e kablrit të kësaj linje. Me tej theksohet se KEDS është përgjegjës për operim për kyçje – shkyçje nën tension, ndërsa për mirëmbajtjen dhe transferimin e aseteve në KEDS, duhet të bëhet marrëveshja me dokumentacion përcjellës (specifikimi i materialit elektrik sipas projektit elektrik). Divizioni i Shpërndarjes në KEDS i ka lëshuar konsumatorit Zgjidhjen Teknike nr.7075, në të cilën theksohet sipas kërkesës së konsumatorit Fehmi Bytyqi që ka të bëjë me dislokimin e linjës 10 kV, KEDS jep këtë zgjidhje teknike përmes skicës, si dhe ka theksuar se para punimeve investitori është i obliguar që të sjellë në KEDS regjistrin e të gjithë punëtorëve dhe emrin e organizatës së licencuar nga MTI bashkë me regjistrin e automjeteve për kryerjen e punimeve.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest dhe vërtetoi se nuk është kontestuese fakti se pika matëse për të cilën konsumatori ka parashtruar ankesë ka ndodhur një defekt në kablirin e furnizimit i cili ka furnizuar pikën matëse të kompanisë “Petrol Oti Slovenija”. Gjithashtu vërtetoi se Pëlqimi Elektroenergjetik i lëshuar me datë 04.10.2011, përkatësisht pika 7 thekson se qartë se, KEK ka në dispozicion të vetin menaxhimin e tërë rrjetin e 10 kV, përfshi edhe pjesën e LP ajror dhe kabllovik të cilin e ka ndërtuar investitori për kyçjen e trafostacionit të vet. Po ashtu KEK do të menaxhojë me një kthinë hyrëse 20 (10) kV në trafostacionin e ri”.

Është konstatuar se bazuar në pikën 7 të Pëlqimit Elektroenergjetik të datës 04.10.2011, KEDS ka qenë e obliguar që me rastin e kërkesës së konsumatorit t’i marrë të gjitha veprimet e duhura konform mandatit që ka në mënyrë që të menaxhojë gjithë problemin teknik të shkaktuar në kablirin furnizues i cili ka furnizuar kompaninë “Petrol Oti Slovenija”.

Bordi gjatë analizimit të kësaj lënde ka vërejtur se KEDS me asnjë provë të vetme nuk e ka vërtetuar faktin se mbi çfarë baze ka ngarkuar konsumatorin me taksën në vlerë financiare prej 354.00€ në mënyrë që të vërtetohet saktë se cilat punime janë kryer nga ana e KEDS. Për me keq edhe përkundër shkresës së datës 18.08.2016 dërguar nga DMK/ZRRE i është kërkuar mes tjerash edhe procesverbali nga KEDS për punët që janë kryer në mënyrë që të verifikohet se mbi cilën bazë i është faturuar taksa e sipërpërmendur. KEDS-i ka dështuar t’i sigurojë DMK në ZRRE procesverbalin e kërkuar madje nuk është përgjigjur fare sa i përket taksës së ngarkuar.



Gjithashtu duhet theksuar se gjatë analizës së dokumentit të KEDS-it për zgjidhjen teknike konstatohet se konsumatori nuk ka bërë kërkesë për dislokimin e linjës 10 kV siç potencohet në dokument, por që konsumatori ka parashtruar kërkesë për rregullimin e kablrit furnizues i cili furnizon konsumatorin.

Bordi i ZRRE gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

**III.** Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

**IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i Rregullatorit:**

\_\_\_\_\_  
Arsim Janova, u.d. kryesues

\_\_\_\_\_  
Besim Sejfiqaj, anëtar

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit N.B dhe,
- Arkivit të ZRRE-së